



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Drejtësisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vonesa në përmbushjen e kontratave;
- A2 Në tre (3) raste kemi vërejtur tejkalim të afateve të parapara ligjore për pozitat si ushtrues detyre;
- A3 Mangësi në proceset e prokurimit.
- B1 Vonesë në pagesën e obligimeve nga 20 deri në 35 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Pagesat nga subvencionet dhe transferet lidhur me mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave potencial të akuzuar pranë Dhomave të Specializuara të cilat kanë qenë të klasifikuara (niveli i kufizuar) nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretarja e Përgjithshme është përgjegjëse edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministria është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ministria ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 40,371,469€.

Fushat për përmirësim janë vërejtur tek shpenzimet, që kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve në kategori ekonomike dhe vonesë në pagesën e faturave. Po ashtu, janë identifikuar mangësi në fushën e menaxhimit të pasurive kapitale dhe jo kapitale dhe prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente.

Ndërsa, sa i përket mos pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, ministria duhet të i forcoj edhe më tej kontrollet sa i përket menaxhimit të kontratave ku kishte mangësi në fushën e prokurimit, vonesa në realizimin e punimeve dhe pagesën e obligimeve.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe katër (4) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi dhe vonesa në përmbushjen e kontratave

Gjetja

Afatet dhe kushtet e liferimit të produkteve/mallit janë të definuara me kontratë dhe afati për dorëzim, do të llogaritet nga koha e lëshimit të urdhërbljes nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK). Në rastet kur Operatori ekonomik nuk arrin që t'i dorëzoj produktet, shërbimet ose punët sipas kushteve të kontratës AK do të ketë të drejtë që të aplikoj penalet apo të konfiskoj sigurinë e ekzekutimit. Ne identifikuam se:

- Tek kontrata për furnizim me kompjuterë, në vlerë 107,795€, kemi vërejtur se operatori ekonomik (OE) kishte bërë një furnizim (liferim) të pjesshëm sipas pozicioneve në kontratë në vlerë 20,110€. Pjesën tjetër të furnizimit me kompjuterë OE nuk kishte arritur ta furnizoje sipas llojit dhe specifikave teknike të kontratës, por kishte ofruar model tjetër të kompjuterëve, e të cilin AK e kishte refuzuar ta pranojë. Si pasojë e papërgjegjësisë së OE-së, menaxheri i prokurimit në koordinim me menaxherin e kontratës ishin detyruar të bëjnë shkëputjen e kontratës.

Në këtë situatë AK-së i janë plotësuar kushtet për konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit siç e parasheh neni 29 (pika 29.8) të rregullorës 001/2022. Për shkak të komunikimeve të shpeshta për zgjidhjen e problemit në lidhje me furnizimin me kompjuter, afati i sigurisë së ekzekutimit kishte skaduar dhe autoriteti kontraktues nuk kishte marr veprime me kohë për vazhdimin e tij, dhe kjo e kishte pamundësuar konfiskimin;

- Furnizimi me mjete mjekësore në vlerë 82,355€ ishte bërë me 23 ditë vonesë. Porosia ishte bërë me datë 02.04.2024, ndërsa pranimi ishte bërë me datë 10.06.2024, përderisa afati për dorëzim sipas kushteve kontraktuale ishte 45 ditë nga momenti i porosisë (nxjerrjes së urdhërbljes); dhe
- Furnizim me veshmbathje në vlerë 38,040€ ishte bërë me 8 ditë vonesë. Urdhërblerja është lëshuar me datë 10.09.2024 ndërsa malli është pranuar më 23.09.2024, përderisa afati për dorëzim sipas kushteve kontraktuale ishte 5 ditë nga momenti i lëshimit të urdhërbljes.

Shkaku i mospërmbushjes së kontratës ishte papërgjegjësia e operatorit por edhe moskujdesi i duhur nga AK-së për konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit. Po ashtu vonesat në liferim të mallit kishin ndodhur kryesisht si rezultat i menaxhimit jo të mirë nga ana e menaxherëve të kontratave duke mos aplikuar penalet.

Ndikimi

Mospërmbushja e kontratës dhe vonesat në liferimin - furnizimin e mallit ndikojnë në ofrimin e shërbimeve dhe në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. Po ashtu, moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit ndikon që AK të mos arrijë të zvogëlojë dëmin e shkaktuar.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që kur OE nuk përmbush kontratën t'iu konfiskohet siguria e ekzekutimit. Po ashtu, duhet siguruar një monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me

furnizimin e mallit që të bëhet në kohë në të kundërtën të bëhet aplikimi i penaleve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre përtej afatit ligjor

Gjetja

Ligji për Zyrtar Publik Nr.08/L-197 në nenin 35 pikën 3 thekson se zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjatet më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.

Në tre (3) raste identifikua se pozitat e punës mbeten me ushtrues detyre mbi një vit, duke tejkaluar afatin ligjor. Pozitat mbaheshin me ushtrues detyre që nga hyrja e ligjit për zyrtarët publik në fuqi (shtator 2023) e deri në kohën sa ne ishim në auditim (maj 2025).

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i dështimit të proceseve të rekrutimit ku në disa procedura nuk kishte aplikim të kandidatëve.

Ndikimi

Tejkalimet e afateve ligjore për Ushtrues Detyre për një periudhë më të gjatë se një vit mund të ndikojë në cilësinë e performancës operationale të entitetit pasi pozitat mund të mbahen nga zyrtarë të cilët nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara për pozitat adekuate.

Rekomandimi A2

Ministrja përmes menaxher-es/it të personelit duhet të siguroj se janë ndërmerr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në fushën e prokurimit

Gjetja

Sipas nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues është i detyruar të përpilojë specifikimet teknike në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në përputhje me qëllimin e kontratës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo favorizimi të operatorëve ekonomikë. Ne identifikua mangësi si:

- Specifikimet teknike në dosje të tenderit si kërkesa mbi ngjyrën dhe ndarjen e kabinës nuk ishin qartësuar mirë të "Furnizimi me automjete (kombi) për Njësine e Transporti të Burgosurve" për SHKK. Pas informatave shtesë me OE ishte qartësuar ngjyra dhe ndarja e kombit të pjesa e shoferit. Kontrata ishte nënshkruar me datë 30.04.2024 në vlerë 98,699€ dhe afat liferimi 80 ditë. Furnizimi me kombi ishte bërë me kohë, por Komisioni kishte konstatuar se këta kombi ishin të dedikuar për bartje të mallrave dhe jo për bartje të burgosurve. Pas kësaj OE i është lejuar afat shtesë nga AK për dorëzim 90 ditë që të plotësoheshin sipas specifikat e kërkuara. Me datë 23.10.2024 ishin pranuar dy kombi (një ngjyrë hiri dhe një e zezë) përkundër se ato sipas sqarimeve shtesë ishin kërkuar të jenë

me ngjyrë të kaltër të mbyllët. Ne gjatë ekzaminimit të njërit nga automjetetet (kombi) vërejtëm se as ngjyra dhe as kabina nuk ishte e ndarë ashtu siç ishte kërkuar; dhe

- Te projekti "Ndërtimi i shtëpisë për nëna, vizita të lira dhe punë tjera ndërtimore, faza e dytë", Ministria kishte hyrë në obligime pa fonde të mjaftueshme. Për këtë projekt me ndarje buxhetore ishin paraparë fonde në vlerë 140,000€ përderisa Ministria kishte nënshkruar kontratën në vlerë 165,000€. Po ashtu, në vitin 2025 në tabelat e buxhetit për këtë projekt nuk kishte mjete buxhetore.

Specifikimet teknike jo të qarta në dosje dhe mos definimi me kohë i tyre ka shkaktuar që automjetet të mos jenë sipas kërkesave të AK-së. Kurse hyrja në obligime pa fonde kishte ndodhur me arsyetimin e departamentit të Inxhinieringut se mjetet do të alokohen gjatë vitit nga një projekt tjetër.

Ndikimi

Mosdefinimi i qartë i specifikimeve në DT ka ndikuar në vonesën e përmbushjes së kontratës dhe ka sjellur edhe deri te mosplotësimi i të gjitha kërkesave të AK-së. Po ashtu, hyrja në obligime kontraktuale pa siguruar fondet përveç anashkalimit të kërkesave ligjore e rrit edhe rrezikun e moszbatimit të kontratës.

Rekomandimi A3

Ministrja, përmes menaxherit të prokurimit dhe njësisë kërkuese, duhet të sigurojë përfshirjen e specifikimeve teknike të qarta dhe të matshme në dosjet e tenderit në mënyrë që të mos rezultojnë me keqinterpretime. Ndërsa lidhja e kontratës për projekt të bëhet vetëm kur fondet janë siguruar, duke mos tejkaluar buxhetin e planifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesë në pagesën e obligimeve

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Katër fatura me vlerë totale prej 92,969€ janë paguar me vonesë nga 20 deri në 35 ditë pas pranimit të tyre, duke tejkaluar afatet e përcaktuara për përmbushjen e obligimeve financiare.

Vonesat janë shkaktuar si rezultat i pranimit të faturave në fund të vitit fiskal, dhe mungesës së kontrolleve të brendshme për monitorimin e afateve dhe menaxhimin e pagesave në kohë.

Ndikimi

Vonesat në pagesën e obligimeve sidomos atyre të fund vitit ndikojnë në implikime buxhetore pasi fondet e ndara nuk mund të shfrytëzohen në vitin fiskal por e ngarkojnë buxhetin e vitit të ardhshëm me obligime të bartura nga viti aktual.

Rekomandimi B1

Ministria duhet të përmirësojë planifikimin financiar dhe menaxhimin e mjeteve financiare në dispozicion, të forcojë kontrollet e brendshme dhe të

sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afateve të përcaktuara, me qëllim shmangien e penaliteteve dhe bartjes së detyrimeve në vitin pasues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe shpenzimet komunale në vitin 2024 ishte 13,202,840€, prej tyre ishin shpenzuar 11,458,874€. Ato kanë të bëjnë me furnizim me ushqim për nevojat e të burgosurve, shpenzime të arbitrazhit, furnizim me material shpenzues, derivate për ngrohje, veshmbathje për stafin korrektues, shërbime komunale, etj.

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Ne identifikuam klasifikime jo adekuate të shpenzimeve në vlerë prej 21,082€ si në vijim:

Shpenzimet me vendime gjyqësore-përmbartimore në vlerë 22,112€ ishin kryer nga kategoria mallra dhe shërbime. Nga kjo shumë 21,082€ kishin të bënin për pagesën e pagave kurse pjesa tjetër prej 1,030€ ishin shpenzime të procedurës gjyqësore. Një zyrtar në Shërbimin Korrektues të Kosovës e kishte fituar rastin në Gjykatë pasi që i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe pagat duhej të i ishin paguar nga kategoria paga dhe mëditje kurse shpenzimet e procedurës nga kategoria mallra dhe shërbime.

Kjo kishte ndodhur për shkak planifikimit jo të duhur të mjeteve me buxhet dhe mos ridestinitimit të mjeteve në kategoritë përkatëse konform natyrës së shpenzimit.

Ndikimi Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultojnë me raportim apo klasifikim jo të saktë të të dhënave në pasqyra financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B2 Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime konkrete në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi në kategorinë përkatëse dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në Pasqyra Financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale për vitin 2024 është 95,530,491€, pasurive jokapitale është 867,410€, si dhe e stoqeve 559,249€.

Çështja B3 - Nënvlërësim i regjistrave të pasurisë në PFV

Gjetja

Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në nenin 3 përcaktohet që Regjistri i Përgjithshëm i Pasurive - është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive jo financiare të zotëruara nga organizatat buxhetore, që nënkupton regjistrin e pasurive kapitale, pasurive jo kapitale dhe stoqeve që azhurnohen rregullisht, dhe që, përveç përdorimit për menaxhim të pasurive, do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Ne identifikuam se pasuritë e paregjistruara në regjistrat kontabël përkatës ishin te:

- Shërbimi Korrektues i Kosovës - dyshekë në vlerë 37,740€ dhe nga Administrata Qendrore e MD-së dy foltore 960€ dhe një dollar 380€. Pasuritë nuk ishin evidentuar në regjistrin e- Pasuria nën 1000€; dhe
- Gjashtë (6) vetura që i janë dhënë në shfrytëzim MD nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar në vlerë 61,500€ nuk ishin regjistruar gjatë vitit 2024 në regjistrin e pasurive në SIMFK. Dy (2) prej tyre që iu kishin dhënë në shfrytëzim SHKK ishin regjistruar në prill të vitit 2025 në vlerë 37,000€, kurse 4 tjera që i ka në shfrytëzim MD në vlerë 24,500€ nuk janë regjistruar fare.

Mungesa e azhuritit në regjistrimin e pasurive dhe komunikimit jo i duhur në mes të departamenteve ka qenë shkak i këtyre mangësive.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive në kohë ndikon në raportimin jo të drejtë të vlerës së pasurive. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B3

Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të siguroj përmes zyrtarëve të pasurive dhe ZKF që çdo pasuri e blerë apo e dhuruar të jetë prezantuar saktë dhe në kohën e duhur në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2024 ishte 479,187€.

Çështja B4 - Prezentim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja	Rregullorja MF nr.01/2017, Neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Ne identifikuar se lënda C.nr.7185/21 në vlerë 43,692€ ishte prezantuar në listën e detyrimeve kontingjente dhe në Pasqyra Financiare përkundër faktit që lënda ishte e përfunduar. Gjykata e Apelit në vitin 2023 i kishte refuzuar palës paditëse kërkesën e saj dhe vlera e detyrimit kontingjent nuk ishte larguar nga lista e tyre. Mos përditësimi i detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat e fundit nga proceset kontestimore ishte shkaktari kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente.
Ndikimi	Prezantimi jo i saktë ka ndikuar në mbivlerësim të detyrimit dhe paraqet gjendjen jo reale të tyre në Pasqyra Vjetore Financiare.
Rekomandimi B4	Ministrja duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe ZKF, në mënyrë që detyrimet kontingjente para se të paraqiten në Pasqyrat Vjetor Financiar të rishikohen lidhur me statusin e tyre, të azhurnohet lista dhe të prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	47,041,887	43,082,118	40,371,469	35,204,319	30,134,916
Grante Qeveritare - Buxheti	46,961,687	42,971,339	40,371,469	35,161,315	30,068,326
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	45,108
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	30,885	1,096
Të hyrat vetanake	80,200	80,200	0	0	16,406
Donacionet e jashtme	0	30,579	0	12,120	3,981

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 3,959,769€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2024, Ministria ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 40,371,469€ me një ulje prej 2% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	47,041,887	43,082,118	40,371,469	35,204,319	30,134,916
Pagat dhe mëditjet	17,295,860	16,859,278	16,776,813	15,424,957	13,079,738
Mallrat dhe shërbimet	10,884,258	12,114,071	10,450,796	7,245,277	7,141,384
Komunalitë	1,088,769	1,088,769	1,008,078	978,326	1,004,225
Subvencionet dhe transferet	9,598,000	10,185,000	10,106,444	10,866,022	7,999,623
Investimet Kapitale	8,175,000	2,835,000	2,029,338	689,737	909,946

MD gjatë vitit 2024 kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 436,582€. Ky zvogëlim ishte bërë me vendimet e Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,229,813€. Kjo ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë ku nga Shërbimi Korrektues i Kosovës shuma prej 1,200,000€, nga kategoria e Investimeve Kapitale janë transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Realizimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 86%;
- Buxheti fillestar dhe final për shpenzime komunale ishte 1,088,769€. Realizimi i buxhetit tek kjo kategori ishte 93%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 587,000€. Kjo ishte edhe si rezultat i kërkesës për mjete shtesë për shpenzimet bazike për strehimoret. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99% e buxhetit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,340,000€, ky buxhet ishte realizuar në një nivel prej vetëm 72%. Në këtë nivel të realizimit kanë ndikuar vonesat në procedurat e prokurimit të cilat kanë filluar me vonesë dhe shkëputjet e kontrateve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MD në 2024 ishin në vlerë 6,621,651€. Të hyrat realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të Gjykatave, nga provimi i Jurisprudencës dhe noterisë dhe nga kompensimet e dëmeve nga kompania e sigurimeve. Krahasuar me vitin e kaluar shohim një rritje të konsiderueshme të të hyrave për 6,127%, kjo për shkak se janë pranuar mjete nga tarifa për shfrytëzimin e burgut (shfrytëzimin e pronave publike) sipas ligjit nr. 08/L -307 neni 32 në vlerë 5,000,000€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	521,093	521,093	6,621,651	106,343	1,085,091
Të hyrat jo tatimore	521,093	521,093	6,621,089	106,343	1,082,012
Të hyrat tjera	0	0	562		3,079

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Ministrisë së Drejtësisë ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2024 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar dhe katër (4) rekomandime ishin përsëritur.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave duke filluar që nga zotimi e deri tek pagesa e faturave.	Gjatë vitit 2024 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
2.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëjë ridestininim të mjeteve sipas kategorive adekuate të shpenzimeve në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Edhe gjatë vitit 2024 kemi identifikuar raste të tilla, tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve.	Nuk është adresuar
3.	Pasuritë	Ministrja duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të siguroj përmes zyrtarëve të pasurive dhe ZKF që çdo pasuri e blerë apo e ndërtuar dhe dëmtuar të jetë prezantuar saktë dhe në kohën e duhur në PFV.	Edhe gjatë vitit 2024 kemi identifikuar raste të tilla.	Nuk është adresuar
4.	Obligimet e papaguara	Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktivitetet e Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar për të shmangur penalizimet për shkak vonësive.	Gjatë vitit 2024 kemi identifikuar raste të njëjta.	Nuk është adresuar
5.	Detyrimet Kontingjente	Ministrja duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe ZKF, në mënyrë që detyrimet kontingjente para se të paraqiten në Raportim Vjetor Financiar të rishikohen nëse janë paguar, të azhurnohet lista dhe të prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë.	Edhe gjatë vitit 2024 kemi identifikuar raste të njëjta.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit




Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Altina Selimi Palushi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr. Pr. Nr.: 01-1495
 Data / Datum / Date: 20.06.2025
 Shtojca / Dodaci / Annex: -1-
 PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

KATEGORIA E DOKUMENTIT
 KATEGORIJA DOKUMENTI

Klas. Org. Klasif. Jedin.	Sht./Klasif. Klasif. Kod	No. Prot. Br. Prot.	No. i fletëve Br. Stranica
03	47	1069	1

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

20.06.2025

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për
 zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Drejtësisë**, për vitin 2024;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Blerim SALLAHU

Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.